



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të
Transfuzionit të Gjakut**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT (Auditim Tematik)

QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

TETOR 2022



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm	5-6
II.	HYRJE	6
1.	Objekti i auditimit	6-7
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	7
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
5.	Përgjegjësitë e Audituesve	7
6.	Kriteret e vlerësimit	7-8
7.	Standardet e auditimit	8
8.	Metodat e auditimit	8-9
9.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9-20
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	10-20
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	20-21



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 548/4 prot., datë 01.07.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.07.2022 deri më datën 02.08.2022, mbi “Auditimin Tematik në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)”, për zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, si dhe për procedurat e pranimit dhe emërimit të stafit mjekësor, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 30.06.2022. Ky auditim është iniciuar nga ankesa e ardhur në KLSH me datë 02.06.2022, protokolluar me nr.548 Prot, ku një mjek transfuziolog sjell problematikën në lidhje me vendet vakante të pashpallura në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna, gjithashtu vlerësimi nëse procedurat e pranimit, emërimit të stafit mjekësor janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) është institucioni qendror i shërbimit të transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë, i cili ka personalitetin juridik publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sa më sipër, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Për “Kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”;
- VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”;
- VKM nr. 555, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar Të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, i ndryshuar;
- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit”;
- Udhëzimit nr. 493 datë 13.11.2017 “Procedurat e rekrutimit të infermierit në institucionet shëndetësore publike në RSH”;
- Udhëzimi nr. 481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në RSH”;
- Udhëzimi nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.
- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 320, datë 21.05.2009 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut”;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 739, datë 13.11.2019, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë”;
- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 111, datë 15.02.2021, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi nëse procedurat e pranimit, emërimit të stafit mjekësor janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë 4 (katër) vende vakante për mjekë, të cilët janë krijuar në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 1 (një) vend vakant në vitin 2022, 2 (dy) prej të cilëve janë plotësuar në Qershor 2021 (proces i cili ka filluar në 25 Mars 2021) dhe një është në proces rekrutimi, i cili ka filluar në Qershor 2022. Si rrjedhojë, duke krahasuar strukturën plan / fakt, konstatohet një vend vakant për mjek, për të cilin nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi. Gjithashtu QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen vendet vakante pas më shumë se 2 muaj, pas krijimit të vakancës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në RSH nëpërmjet platformës elektronike” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.	10-16	I Lartë	QKTGJ të marrë masa për publikimin e vendeve vakante duke respektuar detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.
2	Me Urdhrin nr. 320, datë 21.05.2009, të të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar Rregullorja e Brendshme për funksionimin e QKTGJ-së. Procedura e rekrutimit të stafit, është e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, dhe gjatë periudhës, vitet 2009-2022, kanë ndodhur disa ndryshime në mënyrën e rekrutimit, si dhe pozicioneve të punës. Konstatohet se kjo rregullore nuk është e përditësuar me ndryshimet e ndodhura në bazën ligjore sa i përket procesit të rekrutimit të stafit mjekësor, si dhe të stafit të shkencave mjekësore teknike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e	10-16	I MEËM	QKTGJ dhe MSHMS të bëjnë përditësimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut sipas ndryshimeve të ndodhura në strukturën e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakt

	organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakt dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pikës 13/e.			
3	Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës, duke ju referuar Rregullores së Brendshme të QKTGJ-së, e cila nuk është e përditësuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit. Në disa nga dosjet është konstatuar se ka mangësi si mëposhtë : fleta e inventarit është e pafirmosur nga nëpunësi i njësies së burimeve njerëzore ose ky dokument mungon; dokumentacion i panoterizuar; mungon kontrata individuale e punës, CV, diploma e lista e notave dhe dëshmia e penalitetit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.	16-18	I MESEM	Sektori i Administratës të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.
4	Në kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të QKTGJ, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatësisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, përshkrimi i përgjithshëm i punës nuk ishte specifikuar, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, koha normale e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.	18-19	I MESEM	Sektori i Administratës të marrë masa që të hartojë një format tip të Kontratës Individuale të Punës, që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës.

3. Konkluzioni i përgjithshëm

Nga auditimi në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakt u konstatua se:

- Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë 4 (katër) vende vakante për mjekë, të cilët janë krijuar në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 1 (një) vend vakant në vitin 2022, 2 (dy) prej të cilëve janë plotësuar në Qershor 2021 (proces i cili ka filluar në 25 Mars 2021) dhe një është në proces rekrutimi, i cili ka filluar në Qershor 2022. Si rrjedhojë, duke krahasuar strukturën plan / fakt, konstatohet një vend vakant për mjek, për të cilin nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi. Gjithashtu QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen vendet vakante pas më shumë se 2 muaj, pas krijimit të vakancës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në RSH nëpërmjet platformës elektronike” të Ministrit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Me Urdhrin nr. 320, datë 21.05.2009, të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar Rregullorja e Brendshme për funksionimin e QKTGJ-së. Procedura e rekrutimit të stafit, është e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, dhe gjatë periudhës, vitet 2009-2022, kanë ndodhur disa ndryshime në mënyrën e rekrutimit, si dhe pozicioneve të punës. Konstatohet se kjo rregullore nuk është e përditësuar me ndryshimet e ndodhura në bazën ligjore sa i përket procesit të rekrutimit të stafit mjekësor, si dhe të stafit të shkencave mjekësore teknike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pikës 13/e.

- Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës, duke ju referuar Rregullores së Brendshme të QKTGJ-së, e cila nuk është e përditësuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit. Në disa nga dosjet është konstatuar se ka mangësi si mëposhtë : fleta e inventarit është e pafirmosur nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore ose ky dokument mungon; dokumentacion i panoterizuar; mungon kontrata individuale e punës, CV, diploma e lista e notave dhe dëshmia e penalitetit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

- Në kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të QKTGJ, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatesisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, përshkrimi i përgjithshëm i punës nuk ishte specifikuar, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, koha normale e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.

II. Hyrja

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 548/4 prot., datë 01.07.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.07.2022 deri më datën 02.08.2022, mbi “Auditimin Tematik në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)”, për zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, si dhe për procedurat e pranimit dhe emërimit të stafit mjekësor, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 30.06.2022. Ky auditim është iniciuar nga ankesa e ardhur në KLSH me datë 02.06.2022, protokolluar me nr.548 Prot, datë 02.06.2022, ku një mjek transfuziolog sjell problematikën në lidhje me vendet vakante të pashpallura në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Grupi i auditimit përbëhet nga:

1. B.B., përgjegjës grupi;
2. A.GJ., anëtare;
3. E.T., anëtare.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit: lidhet me zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe pagave, si dhe për procedurat e pranimit dhe emërimit të stafit mjekësor në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

2. Qëllimi i auditimit: është vlerësimi nëse procedurat e pranimit, emërimit të stafit mjekësor janë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

kryer në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

3. Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna, gjithashtu vlerësimi nëse procedurat e pranimit, emërimit të stafit mjekësor janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, sipas drejtimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 548/4 prot., datë 01.07.2022, mbi “Auditimin Tematik në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)”.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) është institucioni qendror i shërbimit të transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë, i cili ka personalitetin juridik publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Organika dhe struktura e QKTGJ-së miratohet me Urdhër të Ministrit të MSHMS-së, me propozim të QKTGJ-së.

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut është përgjegjëse për plotësimin e vendeve vakante të krijuara brenda strukturës së QKTGJ në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH: Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

6. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Për “Kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”;
- VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”;
- VKM nr. 555, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar Të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, i ndryshuar;

- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
- Udhëzimit nr. 493 datë 13.11.2017 “Procedurat e rekrutimit të infermierit në institucionet shëndetësore publike në RSH”;
- Udhëzimi nr. 481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në RSH”;
- Udhëzimi nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.
- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 320, datë 21.05.2009 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut”;
- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 739, datë 13.11.2019, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë”;
- Urdhri i Ministrit të MSHMS-së nr. 111, datë 15.02.2021, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”.

7. Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;
- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

8. Metodot e auditimit: Metodot dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontroleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontroleve.

1. *Kontrolli aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

2. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

3. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. *Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

5. *Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.
6. *Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.
7. *Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

9. Dokumentimi i auditimit: Gjatë ushtrimit të auditimit tematik, objektivi i auditimit është përqendrimi i auditimit në çështje, problematika, tematika, apo sektorë specifikë, aktiviteti i subjektit të audituar është në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse.

Vlerësimi i riskut, në auditimet e tematike (përputhshmërisë), është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Projekt Raporti i Auditimit, i dërguar me anë të shkresës me nr.548/7 prot., datë 09.09.2022, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, si dhe sipas observacioneve të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.252/7 prot., datë 04.10.2022, protokolluar në KLSH me nr.548/8 datë 05.10.2022, u përgatit Raporti i Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Auditimi i ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, në bazë të programit të auditimit nr.548/4 prot., datë 01.07.2022 mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, si dhe për procedurat e pranimit dhe emërimit të stafit mjekësor. QKTGJ e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr. 9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore. Organika dhe struktura e QKTGJ-së miratohet me Urdhër të Ministrit të MSHMS-së, me propozim të QKTGJ-së. Për punësimin e mjekëve në strukturën e saj, QKTGJ duhet të zbatojë parashikimet e Udhëzimit nr. 499, datë 02.07.2019 të Ministrit të Shëndetësisë “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, sipas së cilit QKTGJ është ngarkuar të organizojë procedurat përzgjedhëse.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi, evidencat e marra të auditimit që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

Objekt i këtij auditimi është zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna gjithashtu vlerësimi nëse procedurat e pranimit, emërimit të stafit mjekësor janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

2.1. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave

Në zbatim të programit të auditimit nr. 548/4 prot., datë 01.07.2022, mbi “Auditimin Tematik në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)”, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1.Struktura organizative e QKTGJ-së;
- 2.Procedurat e ndjekura për emërimet, largimet, vendimarrjet përkatëse dhe zbatimin e strukturave organizative për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2022;
- 3.Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 4.Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2022;
- 5.Listëpagesat mujore për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2022.

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura organizative

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) është institucioni qendror i shërbimit të transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë, e cili ka personalitetin juridik publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. QKTGJ e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr. 9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”.


Organika dhe struktura e QKTGJ-së miratohet me Urdhër të Ministrit të MSHMS-së, me propozim të QKTGJ-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

QKTGJ nga data 19.11.2019 deri më datë 15.02.2021, ka kryer funksionet e saj me një numër të përgjithshëm punonjësish, gjithsej 59 punonjës, duke u bazuar në organigramën e miratuar me Urdhrin e Ministrit të MSHMS-së nr. 739, datë 13.11.2019, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë”. Sipas kësaj strukture, QKTGJ është e organizuar mbi bazën e 5 sektorëve: Sektori i Administratës, Sektori i Financës, Sektori i Promocionit, Edukimit dhe Komunikimit, Sektori i Mbledhjes dhe Përpunimit të Gjakut, Sektori i Laboratorëve, si dhe 5 bankave të gjakut pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, SUOGJ “Koço Gliozheni”, SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Spitali Universitar i Traumës. Në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të QKTGJ-së janë zv. Drejtori Ekonomik dhe zv. Drejtori Teknik.

Organigrama e QKTGJ-së ka funksionuar si më poshtë:

STRUKTURA E QENDRËS KOMBËTARE TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT



Burimi: QKTGJ

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut**

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit të Ministrit të MSHMS-së nr. 111, datë 15.02.2021, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”, numri total i punonjësve është 59 punonjës, pra nuk ka ndryshuar. Gjatë periudhës objekt auditimi, në QKTGJ kanë ndodhur ndryshime në strukturë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Struktura e QKTGJ-së e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi është si më poshtë vijon:

Nr.	Muaji	Struktura plan	Struktura fakt	Largime / Rekrutime	Data e krijimit të vendit vakant	Data e dërgimit të kërkesës për vend vakant	Vende Vakante
1	JANAR 2021	59	54		16.11.2018		3 Mjekë + 2 Punonjës Administrate
					03.12.2019		
					09.03.2020		
2	SHKURT 2021	59	55	1 rekrutim administrate			3 Mjekë + 1 Punonjës Administrate
3	MARS 2021	59	55				3 Mjekë + 1 Punonjës Administrate
4	PRILL 2021	59	55				3 Mjekë + 1 Punonjës Administrate
5	MAJ 2021	59	55				3 Mjekë + 1 Punonjës Administrate
6	QERSHOR 2021	59	57	2 rekrutime mjekë		25.03.2021 (2 vende)	1 Mjek + 1 Punonjës Administrate
7	KORRIK 2021	59	57				1 Mjek + 1 Punonjës Administrate
8	GUSHT 2021	59	56	1 largim administratë			1 Mjek + 2 Punonjës Administrate
9	SHTATOR 2021	59	56				1 Mjek + 2 Punonjës Administrate
10	TETOR 2021	59	58	2 rekrutime administratë			1 Mjek
11	NENTOR 2021	59	58	1 largim laborante	10.11.2021		1 Mjek + 1 Laborante
12	DHJETOR 2021	59	57				1 Mjek + 1 Laborante
13	JANAR 2022	59	57				1 Mjek + 1 Laborante



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

14	SHKURT 2022	59	58	1 rekrutim laborante		10.12.2021	1 Mjek
15	MARS 2022	59	57	1 largim laborante	16.03.2022		1 Mjek + 1 Laborante
16	PRILL 2022	59	57	1 largim mjek + 1 rekrutim laborante	01.04.2022	01.03.2022	2 Mjekë
17	MAJ 2022	59	57				2 Mjekë
18	QERSHOR 2022	59	57			06.06.2022	1 Mjek+1 Mjek në proces rekrutimi

Burimi: QKTGJ

Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë 4 (katër) vende vakante për mjekë, të cilët janë krijuar në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 1 (një) vend vakant në vitin 2022, 2 (dy) prej të cilëve janë plotësuar në Qershor 2021 (proces i cili ka filluar në 25 Mars 2021) dhe një është në proces rekrutimi, i cili ka filluar në Qershor 2022. Si rrjedhojë, duke krahasuar strukturën plan / fakt, konstatohet një vend vakant për mjek, për të cilën nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi.

b. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna

Me Urdhër të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. 320, datë 21.05.2009 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut” është miratuar rregullorja e brendshme e QKTGJ-së.

VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimit e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, e ka klasifikuar Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, si Strukturë Shëndetësore Universitare, e cila ofron shërbime shëndetësore dhe funksione mësimore e kërkimore shkencore në fushën e mjekësisë transfuzive.

Sa mësipër, për punësimin e mjekëve në strukturën e saj, QKTGJ duhet të zbatojë parashikimet e Udhëzimit nr. 499, datë 02.07.2019 të Ministrit të Shëndetësisë “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, sipas së cilit QKTGJ është ngarkuar të organizojë procedurat përzgjedhëse. Në zbatim të këtij udhëzimi, QKTGJ ndër të tjera ka detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji, si dhe në cilësinë e organit kompetent të komisionit të vlerësimit, brenda pesë ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, duhet të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët në përputhje të plotë me skemën e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, e përcaktuar në shtojcën 1 të udhëzimit. Pas vlerësimit të dokumentacionit, brenda dy ditëve shpall emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit dhe ia dërgon DQOSHKSH për t’i publikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë”. Gjithashtu në të njëjtën ditë, që publikohet lista me emrat e kandidatëve, i njofton ata nëpërmjet postës elektronike, për pikët që ka marrë nga vlerësimi i dosjes si dhe për datën dhe vendin e intervistës. Komisioni i Vlerësimit ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe brenda dy ditëve i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet postës elektronike.

Grupi i auditimit konstatoi se për rekrutimin e 2 (dy) punonjësve në pozicionin mjek transfuziolog, procedura e ndjekur nga QKTGJ ka patur disa mospërputhje me parashikimet sipas Udhëzimit 499/2019. Së pari, QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen dy vendet vakante pas më shumë se 1 vit, pas krijimit të vakancës. Procesverbali me nr. 67/2 prot., datë 24.05.2021, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit nuk ka pasqyruar pyetjet që ju janë bërë kandidatëve gjatë fazës së intervistës me gojë, në mënyrë që të konfirmohet që pyetjet kanë qenë të njëjta për të dy kandidatët.

Gjithashtu, është konstatuar se për të dyja kandidatët, në emailin njoftues nga ana e QKTGJ për kualifikimin në fazën e dytë nuk i janë përcjellë secilës prej tyre pikët që kanë përfituar në fazën e parë të verifikimit të dokumentacionit, në përputhje me procedurën e rregulluar me Udhëzimin 499/2019.

Referuar shtojcës 1, të Udhëzimit 499/2019, e cila ka përcaktuar kriteret dhe skemën e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për mjek të përgjithshëm dhe mjek specialist, në asnjë rast kandidati nuk mund të vlerësohet me më shumë se 4 pikë lidhur me dëshmitë e gjuhëve të huaja. Sa më sipër është konstatuar se të dy kandidatët janë vlerësuar me 5 pikë për këtë kriter. Në kuptim të pikës 6, të shtojcës sipërcituar, kandidati do të përfitojë pikë mbi dëshmi dhe kualifikime të tjera vetëm nëse kualifikimet do të jenë mbi 3-mujore. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se kandidatja R. Gj. nuk e plotëson këtë kusht dhe nga ana e komisionit është vlerësuar me 2 pikë.

Në rastin konkret këto diferenca në pikë nuk sjellin asnjë pasojë në procedurën e rekrutimit, por nëse do të kishte kandidatë të tjerë, kjo parregullsi do të sillte pasoja në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve fitues.

Në lidhje me vendin vakant të krijuar në datë 01.04.2022, si rrjedhojë e dorëheqjes së një mjeku Transfuziolog, QKTGJ ka dërguar në datë 06.06.2022 Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale njoftimi për shpallje vendi vakant për një mjek Transfuziolog. Në këtë rast QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen një vend vakant 2 muaj, pas krijimit të vakancës.

Më datë 13.06.2022 ka ardhur nga MSHMS miratimi i kërkesës për vazhdimin e procedurave për shpalljen e vendit vakant për mjek, dhe i është dërguar OQOSHKSH me datë 16.06.2022 kërkesa për shpalljen e vendit vakant në portalin “Mjekë për Shqipërinë”, procedurë në proces.

Personeli infermieror dhe teknik laborator është punësuar sipas Udhëzimit nr.493 datë 13.11.2017 “Procedurat e rekrutimit të infermierit në institucionet shëndetësore publike në RSH”, Udhëzimit nr. 481 datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në RSH” (fletore zyrtare 98/2019). Për stafin infermierë dhe laborant, QKTGJ është ngarkuar të identifikojë vendet e lira të punës që krijohen dhe ti raportojë tek DROSHKSH-ja përkatëse brenda 2 (dy) ditëve nga data e krijimit të vakancës. Në vijim, e gjithë procedura e shpalljes së vendit në portal dhe deri në ndjekjen e procedurës së konkurrit dhe pranimin ndiqet nga DQOPSHKSH, e cila është ngarkuar si institucioni përgjegjës dhe DROSHKSH, e cila është ngarkuar të organizojë procedurat. Në përfundim të procesit, DROSHKSH-ja duhet të përcjelli pranë QKTGJ-së vërtetimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues, si dhe me fletët e printuara nga portali për rezultatin e tij dhe kjo e fundit të vijojë me nënshkrimin e kontratës së punës.

Në lidhje me punësimet për personel infermieror dhe teknik laborator gjatë periudhës objekt auditimi pasi është liruar një vend për laborante, Qendra Kombëtare e transfuzionit të gjakut ka dërguar kërkesën për plotësim vendi vakant për laborante me datë 10.12.2021. DROSHKSH me datë 09.02.2022 ka sjellë shkresën për emërimin e kandidatit fitues nga Portali “Infermiere për Shqipërinë”, më datë 15.02.2022 ka dal urdhri për emërimin e laborantes.

Ministria e Shëndetësisë me anë të urdhrit nr. 134 prot., datë 23.02.2022 ka vendosur transferimin e një laborante nga QKTGJ pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Për plotësimin e këtij vendi u dërgua nga ana e QKTGJ kërkesa për plotësim vendi vakant në datë 01.03.2022 dhe më datë 15.04.2022 ka ardhur emërimi nga portali “Infermiere për Shqipërinë” për një laborante, më datë 19.04.2022 ka dal urdhri për emërimin e laborantes.

Gjithashtu ka pasur emërim provizor të emëruar nga DROSHKSH sipas portalit “Infermiere për Shqipërinë” për një infermiere që ka qenë me leje lindje.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

Për periudhën objekt auditimi kemi gjithsej 4(katër) largime nga puna, për arsye të mëposhtme:

	Nr	Personeli	Pozicioni	Mënyra e Largimit
Largime për periudhën 2021-2022	1	L.Q.	Mjeke Transfuziologe	Larguar me kërkesë dorëheqje të mjekes
	2	D.D.	Laborante	Larguar me urdhër transferimi nga MSHMS
	3	S.B.	Laborante	Larguar për arsye dalje në pension
	4	M.M.	Infermiere	Larguar pas përfundimit të kontratës (Infermiere provizore)

Burimi: QKTGJ

Me Urdhër të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 320, datë 21.05.2009 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të Transfuzionit të Gjakut” është miratuar Rregullorja e Brendshme e QKTGJ-së. Procedura e rekrutimit të stafit, është e cituar në Rregulloren e Brendshme, ku konstatohet se kjo rregullore nuk është e përditësuar me ndryshimet e ndodhura në bazën ligjore sa i përket procesit të rekrutimit të stafit mjekësor, si dhe të stafit të shkencave mjekësore teknike. Dhe pse, gjatë periudhës kanë ndodhur disa ndryshime në mënyrën e rekrutimit, si dhe pozicioneve të punës, QKTGJ vazhdon të funksionojë sipas kësaj rregullore. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pikës 13/e, ku citohet... “Drejtori i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut ndër të tjera ka përgjegjësi kryesore: I propozon Komitetit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut, për miratim nga ministri i Shëndetësisë, të rregullores së brendshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.”

Titulli i gjetjes nr.1	Strukturë e paplotësuar me staf mjekësor
Situata	Grupi i auditimit konstatoi se për rekrutimin e 2 (dy) punonjësve në pozicionin mjek transfuziolog, procedura e ndjekur nga QKTGJ ka patur mospërputhje me parashikimet sipas Udhëzimit 499/2019. QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen dy vendet vakante pas më shumë se 1 vit, pas krijimit të vakancës. Në lidhje me vendin vakant të krijuar në datë 01.04.2022, si rrjedhojë e dorëheqjes së një mjeku Transfuziolog, QKTGJ ka dërguar në datë 06.06.2022 Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale njoftimin për shpallje vendi vakant për një mjek Transfuziolog. Në këtë rast QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen një vend vakant 2 muaj, pas krijimit të vakancës. Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë 4 (katër) vende vakante për mjekë, të cilët janë krijuar në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 1 (një) vend vakant në vitin 2022, 2 (dy) prej të cilëve janë plotësuar në Qershor 2021 (proces i cili ka filluar në 25 Mars 2021) dhe një është në proces rekrutimi, i cili ka filluar në Qershor 2022. Si rrjedhojë, duke krahasuar strukturën plan / fakt, konstatohet një vend vakant për mjek, për të cilën nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në RSH nëpërmjet platformës elektronike”.
Ndikimi/Efekti:	Struktura organike e QKTGJ e paplotësuar me mjekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit

Shkaku:	Mos publikimi i vendit vakant nga ana e QKTGJ në platformën elektronike ka shkaktuar një strukturë të paplotësuar.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	QKTGJ të marrë masa për publikimin e vendeve vakante duke respektuar detyrimin të raportoje në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtori i QKTGJ-së, z. K.R. dhe Shefi i Sektorit të Administratës, znj. B.L.

Titulli i gjetjes nr.2	<i>Rregullorja e Brendshme e QKTGJ-së nuk është e përditësuar me bazën ligjore në fuqi</i>
Situata:	Me Urdhrin nr. 320, datë 21.05.2009, të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar Rregullorja e Brendshme për funksionimin e QKTGJ-së. Procedura e rekrutimit të stafit, është e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, dhe gjatë periudhës, vitet 2009-2022, kanë ndodhur disa ndryshime në mënyrën e rekrutimit, si dhe pozicioneve të punës. Konstatohet se kjo rregullore nuk është e përditësuar me ndryshimet e ndodhura në bazën ligjore sa i përket procesit të rekrutimit të stafit mjekësor, si dhe të stafit të shkencave mjekësore teknike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjaktit dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pikës 13/e, ku citohet... “Drejtori i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit ndër të tjera ka përgjegjësi kryesore: I propozon Komitetit Kombëtar të Transfuzionit të Gjaktit, për miratim nga ministri i Shëndetësisë, të rregullores së brendshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit.”
Kriteri:	VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjaktit dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”; Urdhri i Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 320, datë 21.05.2009 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjaktit” është miratuar rregullorja e brendshme e QKTGJ-së.
Ndikimi/Efekti:	Rregullorja aktuale nuk është koherente me strukturën organike në fuqi.
Shkaku:	Mos koherenca midis strukturës dhe rregullores krijon vështirësi në punën e institucionit të QKTGJ.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	QKTGJ dhe MSHMS të bëjnë përditësimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjaktit sipas ndryshimeve të ndodhura në strukturën e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtori i QKTGJ-së, z.K.R. dhe Shefi i Sektorit të Administratës, znj. B.L.

c. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës duke u bazuar në VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, e cila përcakton se:

1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrave, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se: Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezja e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 18 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

Nr	Personeli	Pozicioni	Dosja e Personelit (mangësitë)
1	G.D.	Laborante	<i>Mungon:</i> CV <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Leje për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime, Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja
2	R.Gj.	Mjeke Transfuziologe	<i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Certifikata pjesëmarrje në trajnime
3	E.B.	Mjeke Transfuziologe	<i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Certifikata pjesëmarrje në trajnime
4	E.B.	Laborante	<i>Mungon:</i> CV, Certifikata personale dhe familjare <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Leje për ushtrimin e Profesionit
1	A.D.	Mjeke Transfuziologe	<i>Mungon:</i> Certifikata personale dhe familjare <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime, Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja
2	D.SH.	Mjeke Transfuziologe	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Dëshmi penaliteti <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
3	A.M.	Mjek Transfuziolog	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Certifikata personale dhe familjare, Kontratë Individuale Pune, Dëshmi penaliteti <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
4	Xh.B.	Mjeke Transfuziologe	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Diplomë specializimi dhe lista e notave përkatëse, Kontratë Individuale Pune <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
5	M.S.	Mjeke Transfuziologe	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Certifikata personale dhe familjare, Lista e notave mjekësi e përgjithshme, Kontratë Individuale Pune, Dëshmi penaliteti <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
6	V.S.	Mjeke Transfuziologe	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Certifikata personale dhe familjare, Kontratë Individuale Pune, Dëshmi penaliteti <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit, Certifikatë specializimi, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
7	A.Z.	Mjek Transfuziolog	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari (e pafirmosur) <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> License për ushtrimin e Profesionit
8	N.H.	Infermiere	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari (e pafirmosur), Certifikata familjare <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Leja për ushtrimin e Profesionit, Certifikata pjesëmarrje në trajnime
9	V.K.	Infermiere	<i>Mungon:</i> Fletë Inventari, Certifikata personale dhe familjare, Kontratë Individuale Pune <i>Dokumenta të panoterizuar:</i> Leja për ushtrimin e Profesionit

Burimi: QKTGJ

Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës, duke ju referuar Rregullores së Brendshme të QKTGJ-së, e cila nuk është e përditësuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit, është konstatuar se:

- dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit, e cila në 10 dosje është e pafirmosur nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore ose mungon;
- në 14 dosje dokumentacioni është i panoterizuar;
- në 5 dosje mungon kontrata individuale e punës;
- në 2 dosje mungon CV;
- në 2 dosje mungon diploma dhe lista e notave;
- në 4 dosje mungon dëshmia e penalitetit;
- në 7 dosje mungojnë certifikatat personale dhe familjare.

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.

Titulli i gjetjes nr. 3	Mangësi dokumentacioni në dosjet e personelit
Situata:	Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës, duke ju referuar Rregullores së Brendshme të QKTGJ-së, e cila nuk është e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

	përditësuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit. Në disa nga dosjet është konstatuar se ka mangësi si mëposhtë : fleta e inventarit është e pafirmosur nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore ose ky dokument mungon; dokumentacioni i panoterizuar; mungon kontrata individuale e punës, CV, diploma e lista e notave dhe dëshmia e penalitetit.
Kriteri:	- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit”;
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi sjell që dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturës së Administratës
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Spektori i Administratës të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Shefi i Sektorit të Administratës, znj. B.L.

d. Kontratat e punës

Në zbatim të pikës 10, të VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, marrëdhëniet e punës së punonjësve të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut rregullohen nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21 pika 3, përcaktohet se:

Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos:

a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive;

Në 18 kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të QKTGJ, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatësisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, përshkrimi i përgjithshëm i punës nuk ishte specifikuar, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, koha normale e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.

Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës

Nga informacioni i përcjellë nga strukturat përkatëse pranë QKTGJ, u konstatua se për periudhën e auditimit nuk ka patur çështje gjyqësore lidhur me marrëdhëniet e punës.

Marrëdhëniet e pagave

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Janar, Shkurt, Korrik dhe Dhjetor 2021, si dhe Janar, Shkurt 2022. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

listëprezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo drejtorie dhe përgjegjësit respektivë, si dhe janë nënshkruar nga zv. Drejtori Ekonomik si dhe Drejtori i QKTGJ.

Në sektorin e financës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Titulli i gjetjes nr. 4	<i>Mangësi të elementëve të domosdoshëm në kontratat e punës.</i>
Situata:	Në kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të QKTGJ, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatësisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, përshkrimi i përgjithshëm i punës nuk ishte specifikuar, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, koha normale e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.
Kriteri:	Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pika 10.
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi në hartimin kontratave të punës pasi kanë mangësi të elementëve të kërkuar.
Shkaku:	Mungesa e elementëve të domosdoshëm në Kontratën Individuale të Punës
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Administratës të marrë masa që të hartojë një format tip të Kontratës Individuale të Punës, që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Shefi i Sektorit të Administratës, znj. B.L.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 252/7 prot., datë 04.10.2022, protokolluar në KLSH me nr. 548/8 prot., datë 05.10.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Në lidhje me plotësimin e vendeve vakante mjek sipas strukturës aktuale të miratuar nga MSHMS me nr 111 datë 15.02.2021, vendi vakant që ishte në proces rekrutimi ka përfunduar dhe është plotësuar me kandidatin e shpallur fitues duke ndjekur zbatimin e Udhëzimit Nr 499 datë 02.07.2019. Për vendin tjetër theksojmë si dhe me parë që mbështetur rregullores së brendëshme që vazhdon të jetë në fuqi Drejtuesi i Institucionit duke qenë se është dhe mjek i QKTGjakut aktualisht shërben dhe si mjek dhe me largimin e tij nga funksioni drejtues ai do të vazhdoj funksionin si mjek i QKTGj;
- Në lidhje me përditësimin e Rregullores së Brendëshme si dhe e kemi theksuar grupi i ngritur për të punuar dhe përfunduar draftin është drejt përfundimit dhe do e dërgojmë për miratim në MSHMS;
- Në lidhje me dosjet e personelit të audituara por dhe për të gjitha dosjet në total janë plotësuar me dokumentet e munguara dhe po vazhdohet në vijmësi për plotësimin e tyre sipas VKM nr.833, datë 28.10.2020;
- Në lidhje me kontratat individuale për plotësimin e elementëve të munguar është bërë plotësimi i tyre mbështetur në parashikimet e Kodit të Punës Nr 7961 datë 12.07.1995 i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa i takon vendit vakant në strukturën e QKTGJ-së, theksojmë se për periudhën objekt auditimi, ky



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

pozicion ka mbetur i paplotësuar, pavarësisht strukturës së miratuar nga Ministri i MSHMS-së. Objeksioni i dërguar nuk mbështetet në rregulloren e brendshme aktuale miratuar me Urdhrin nr. 320, datë 21.05.2009, të Ministrit të MSHMS, Kreu III, Neni 14, Detyrat dhe të drejtat e Drejtorit të QKTGJ”, pika 19 citohet... “Drejtori me heqjen e mandatit i ofrohet një pozicion pune sipas specialitetit përkatës”. Struktura e QKTGJ-së, nuk mund të qëndrojë e paplotësuar me mjek deri në momentin e largimit të drejtorit aktual nga ky pozicion. Rregullorja e QKTGJ është e pamiruar nga Ministri i MSHMS-së, gjatë periudhës objekt auditimi. Observacioni nuk merret parasysh pasi argumentimi juaj nuk është mbështetur në dokumentacion shtesë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë 4 (katër) vende vakante për mjekë, të cilët janë krijuar në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 1 (një) vend vakant në vitin 2022, 2 (dy) prej të cilëve janë plotësuar në Qershor 2021 (proces i cili ka filluar në 25 Mars 2021) dhe një është në proces rekrutimi, i cili ka filluar në Qershor 2022. Si rrjedhojë, duke krahasuar strukturën plan / fakt, konstatohet një vend vakant për mjek, për të cilin nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi. Gjithashtu QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen vendet vakante pas më shumë se 2 muaj, pas krijimit të vakancës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në RSH nëpërmjet platformës elektronike”, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1a dhe 2.1b, në faqet 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: QKTGJ të marrë masa për publikimin e vendeve vakante duke respektuar detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin nr. 320, datë 21.05.2009, të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar Rregullorja e Brendshme për funksionimin e QKTGJ-së. Procedura e rekrutimit të stafit, është e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, dhe gjatë periudhës, vitet 2009-2022, kanë ndodhur disa ndryshime në mënyrën e rekrutimit, si dhe pozicioneve të punës. Konstatohet se kjo rregullore nuk është e përditësuar me ndryshimet e ndodhura në bazën ligjore sa i përket procesit të rekrutimit të stafit mjekësor, si dhe të stafit të shkencave mjekësore teknike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 505, datë 06.07.2016 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore”, pikës 13/e.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1a dhe 2.1b, në faqet 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: QKTGJ dhe MSHMS të bëjnë përditësimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut sipas ndryshimeve të ndodhura në strukturën e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Brenda datës 31.12.2022

3. Gjetje nga auditimi: Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Administratës, duke ju referuar Rregullores së Brendshme të QKTGJ-së, e cila nuk është e përditësuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohen dokumentet që duhet të mbajë dosja e të punësuarit. Në disa nga dosjet është konstatuar se ka mangësi si mëposhtë: fleta e inventarit është e pafirmosur nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore ose ky dokument mungon; dokumentacion i panoterizuar; mungon kontrata individuale e punës, CV, diploma e lista e notave dhe dëshmia e penalitetit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1c, në faqet 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Administratës të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të QKTGJ, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatësisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, përshkrimi i përgjithshëm i punës nuk ishte specifikuar, kohëzgjatja e pushimeve të paguara, koha normale e punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1d, në faqet 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Sektori i Administratës të marrë masa që të hartojë një format tip të Kontratës Individuale së Punës, që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës.

Brenda 6 muajve dhe në vijimësi

KONTROLI I LARTË I SHTETIT